



Datë: 01.03.2023

KONKURS PËR DIZENJIMIN E LOGOS TË QENDRËS PIRAMIDA

Qendra Piramida ('**Qendra**') është një organizatë jofitimprurëse e themeluar nga Bashkia Tiranë dhe Fondacioni Shqiptaro - Amerikan për Zhvillim. Qendra ka për qëllim administrimin e ambienteve të godinës së Piramidës të Tiranës dhe kthimin e saj në një qendër shumë-funksionale dhe të vetë qëndrueshme. Qendra synon zhvillimin e krijimtarisë përmes teknologjisë, nxitjen e aktiviteteve artistike, social-kulturore dhe edukative në qytetin e Tiranës.

Me përfundimin e rikonstruksionit të godinës dhe në kuadrin e promovimit të imazhit dhe të identitetit të ri të institucionit, Qendra shpall konkursin për krijimin e logos së re.

Krijim i logo dhe brandbook :

Logoja e re duhet të përfaqësojë simbolikën, historinë e godinës, filozofinë e institucionit dhe konceptin e rijetësimin të tij në një qendër teknologjie. Logo duhet të jetë e thjeshtë për t'u perceptuar dhe e aplikueshme për çdo formë përdorimi. Krahas logos duhet të ketë dhe një material udhëzues për identitetin (brand-in) e piramidës.

Informacione të përgjithshme

1. Konkursi është i hapur për të gjithë të interesuarit;
2. Punimet duhet të jenë origjinale, të pa publikuara më parë dhe autori duhet të pranojë përgjegjësi ligjore për sa i përket autenticitetit të punimeve të dorëzuara;
3. Punimet dhe materialet do të dorëzohen të shoqëruara me një deklaratë të autorit;
4. Të gjitha punimet që plotësojnë të gjitha kriteret do të prezantohen për votim përpara një jurie me përfaqësi të Qendrës Piramida, Bashkia Tiranë dhe AADF;
5. Punimi i vlerësuar me pikët më të larta nga juria do të shpallet fitues;
6. Në përfundim të konkursit, me dorëzimin e produktit përfundimtar, fituesi i konkursit pranon t'i transferojë të drejtat ekskluzive Qendrës Piramida;

Dorëzimi i produktit përfundimtar në konkurs duhet të përfshijë:

7. Koncept i logos, disa aplikime dhe shembuj të përdorimit të saj;
8. CV dhe portofol punësh të ngjashme të aplikantit.

Fituesi i konkursit, pas shpalljes si fitues, do t'i kërkohet të zhvillojë të gjithë materialet shoqëruese të brandimit ku do të përshihet lista si më poshtë :

- Koncept Logo
- Struktura e Logos, përdorime korrekte, përdorime jokorrekte
- Animacion i Logos
- Paleta e ngjyrave të logos (Primare, sekondare) dhe rregulla përdorimi të tyre



Albanian-American
Development Foundation



- Font i përdorur (përfshirë të gjithë llojet e shkrimit)
- Shembuj të përdorimit të logos në vizuale
- Ikonografi
- Materiale kancelarike dhe promociionale ku përfshihen: kartëvizita, zarfe, letra zyrtare A4, materiale promociionale, e-mail signature, uniforma, sinjalistika, template powerpoint, etj.

Afati i aplikimit dhe çmimi i konkursit:

Ftojmë të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në konkurs dhe të paraqesin propozimet dhe punimet e tyre. Buxheti limit për këtë konkurs është USD 5,000.

Punimet duhen të dorëzohen në format elektronik, brenda datës **31 Mars 2023**, ora 12:00 am në adresën prokurime@piramida.edu.al.